



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbikqyrje punimesh per objektin “**Rikonstruksion i rrjetit te linjes se furnizimit te ujesjellesit nga Impianti i Bovilles - Depo Maloku, Bashkia Kamez**”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **71247000-1**
Mbikëqyrja e punës së ndërtimit.

VLERA E FONDIT LIMIT: **1 363 426 (Një milion e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKK sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtoja 8).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata timore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2023 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktiveve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **ninin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nentin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulan kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulencë”.**

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbrushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbrushur nëse në bilancin/et e kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Ndërsa në **nentin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbrushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistikës miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021, 2022, 2023) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos

kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogel se 20 % te vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77 pika 1/c** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik¹*” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) gjendjen ekonomike dhe financiare;... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të*

përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nemin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkeshave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkeshave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

6. Autoriteti/enti kontraktor, përvëç kërkeshave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ndërsa në **nemin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitten e pjesëmarrjes së bisnesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkeshat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkuption se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licënsë profesionale të shoqërisë për mbikqyerje të punimeve të zbatimit në ndërtim, si dhe në licënsë të disponojnë kategoritë e nevojshme për mbikqyrjen e punimeve të zbatimit objekt i kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licënsën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit

“të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar). Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë në fushën e mbikqyrjes së punimeve të përgjithshme dhe speciale të ndërtimit të mëposhtme:

- **Kategoria NP-1** (*Punime gjermimi në tokë*)
- **Kategoria NP-4** (*Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*)
- **Kategoria NP-7** (*Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje*)
- **Kategoria NS-1** (*Punime për prishjen e ndërtimeve*)
- **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*)

* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse në plotësimin e liçensave profesionale të kërkua të ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, licensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër shërbimet për të cilat kërkohet licensa profesionale.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

Në **ninen 41** “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*” **pika 4/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), ndër të tjera përcaktohet se, citojmë: “*4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve të investimit për të cilin kërkohet shërbimi i mbikqyrjes objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” (të ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 610, datë 22.09.2022 “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së*

dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” (i ndryshuar), pika 1 dhe 16 e tij, në të cilën përcaktohet se, citojmë: “1. Çdo individ apo subjekt juridik, që kërkon të ushtrojë veprimitari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse sipas përcaktive të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale, bashkëlidhur këtij vendimi... 16/1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimitari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.”, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës** duhet të disponojnë liçensën profesionale për mbikqyrjen e punimeve, si dhe kategoritë e kérkuara të përcaktuara në përputhje me natyrën e punimeve objekt investimi për të cilin kërkohet shërbimi i mbikqyrjes së punimeve, të cilat janë: **kategorinë NP-1** (*Punime gërmimi në tokë*) në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për punimet e gërmimit (*Hedhje, rrafshim, mbushje dhei...; Gërmim dhei me eskavator me goma..., etj.*); **kategorinë NP-4** (*Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*) e cila përfshin të gjitha zërat e punimeve në preventiv për punimet e rikonstrukzionit të rrugës (*Shtrese binderi, shtrese asfaltobetoni etj.*); **kategorinë NP-7** (*Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje*) në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për punimet e ujësjellësit (*Vendosje tuba dhe rakorderi, vendosje ujematesi etj.*); **kategorinë NS-1** (*Punime për prishjen e ndërtimeve*) në lidhje me zërat e punimeve të prishjes në preventiv (*Prishje shtresash asfalti, cakulli... etj., heqje dyer/ dritare... etj.*); **kategorinë NS-18** (*Punime topogjeodezike*) - duke qënë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike, është e nevojshme zotërimi dhe i kësaj pike liçense, **kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcione me objektin e kontratës**.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njobjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **ISO 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose *ekuivalente me të, të njobur nga Standartet Shqipëtare*, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të janë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të janë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77 pika 1/a, 2** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik¹*” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimitarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtar profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nemin 41** “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve” **pika 5/c dhe 6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjera përcaktohet se, citojmë:

“5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:... c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

Gjithashtu në **nemin 44** “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së shërbimit objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të kryhen (ato të mbikqyerjes së punimeve ndërtimore), njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë

kérkesat e cilësisë për këto shërbime (ISO 9001), dhe të sistemit të menaxhimit të mjedisit (*ka të bëjë me aftësinë e operatorëve ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi*) (ISO 14001), si dhe për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (*ka të bëjë me aftësinë e operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor*) (ISO 45001).

Njësia e prokurimit përcaktoj kérkesën si më lart, duke qënë se është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njojjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre (*besueshmërinë*) për përbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 5 (pesë) punonjës për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihet edhe stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

2. Listepagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimumi 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimumi 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) *inxhinier që përbush kriteret për të qenë përgjegjës në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të shërbimit*, sipas kérkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”

dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, ku për përbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/ diploma/ çertifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/ licencuar/ certifikuar shqiptar ose i huaj.

Argumentimi:

Kërkosat e mësipërme bazohen në **nemin 77** pika **1** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkosat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkosat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar konratën që do të jepet. Të gjitha kërkosat duhet të kenë lidhje dhe të janë proporcionale me objektin e konratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar konratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar konratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të konratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e konratës ose në ftesën për shprehje interesit kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kritereve.”*

Në **nemin 41** “Kërkosa të vecanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/b** dhe **c** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”

Në mbështetje të përcaktiveve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t'u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkuption se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej **5 (pesë) punonjës**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 41 pika 4/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e stafit teknik të inxhinierëve që nevojitet për realizimin e shërbimit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 7 “*Termat e Referencës*” dhe llojit të punimeve që do të kryhen, për të cilat kërkohet shërbimi i mbikqyrjes së tyre, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjt nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.
2. Me qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij, njësia e prokurimit referuar natyrës së punimeve për të cilat kërkohet shërbimi i mbikqyrjes objekt kontrate, vlerëson se, **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkua e përealizimin e shërbimit të mbikqyrjes së punimeve**. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (*nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik*), ku më hollësish, është kërkuar: minimuni 1 (*një*) Inxhinier Ndërtimi – në lidhje me mbikqyerjen e punimeve *ndërtimore të rikonstruksionit të objektit*; minimuni 1 (*një*) Inxhinier Hidroteknik, në lidhje me mbikqyerjen e punimeve të *instalimeve hidraulike*, si dhe minimuni 1 (*një*) Inxhinier Gjeodet/Topograf/ Markshajder, pasi do të kryejë mbikqyerjen e *azhornimeve topografike dhe kontrollin e zbatimit kuotave sipas projektit*, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” (i ndryshuar), dhe me qëllim vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.
3. Gjithashtu, në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (*një*) inxhinier që përbush kriteret për të qenë përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë gjatë realizmit të shërbimit të mbikqyrjes së punimeve, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë

është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky punonjës i certifikuar **nevojitet** për mbikqyrjen e përshtatjes së kantierit sipas fazave të punimeve, të mbajtjes së kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eleminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”.

Stafi teknik (inxhinierët) i kualifikuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njofteimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi **1 (një) Pajisje Total Station** në gjendje teknike pune, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës. Në rast se pajisja është në pronësi të tij duhet të paraqesë faturën tatimore të blerjes, ndërsa në rast se pajisja disponohet me qira/ huapërdorje, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerasë/ huapërdorjes (afati i së cilës të përfshijë periudhën e shërbimit objekt prokurimi) dhe dokumentat e pronësisë së qiradhënësит.

Disponimi i pajisjes do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njofteimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjera përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç

është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesit kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë përmbytjen e këtyre kritereve.”

Në **nemin 41** “Kërkesat të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/ç** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:..., ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbytjesh kontratën.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere, janë kritere detyruese edhe si të tillë duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme. Referuar shërbimit që kërkohet dhe bazuar në preventivin e punimeve për të cilat kërkohet shërbimi i mbikqyrjes, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (*një*) pajisje Total Station, me qëllim kontrollin e piketimeve të punimeve që do të kryhen sipas projektit. Njësia vlerëson se pa këtë pajisje një operator ekonomik nuk mund të realizojë kontrollin e atyre punimeve që kanë dhe natyrë topografike.

2.3.8 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”, si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”. **Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përllogaritjes sipas përcaktiveve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s'kualifikim.**

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 80** pika **2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjisacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjisacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.”

Në **nemin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 5/ç** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit

Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:... ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Në nenin 7 “Përcaktimi i tarifave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **354, datë 11.05.2016** “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**1. Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik.**”

Në shkresën **Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017** “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” të Agjensisë së Prokurimit Publik, drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë, APP-ja ndër të tjerash rekomandon se, citojmë: “**3. Në paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të përllogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”.**”

Në mbështetje të përcakttimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, dhe rekomandimit të APP-së, autoriteti kontraktor vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin vlerën e ofertës së tyre për shërbimin që kërcohët në përputhje me përcaktimet e Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”, dhe se tarifa e shërbimit duhet të përllogaritet sipas kategorisë dhe grupit tarifor ku bën pjesë objekti i prokurimit, ku për këtë qëllim duhet të paraqesin dhe Analizën e përllogaritjes së ofertës sipas VKM-së Nr. 354, datë 11.05.2016, mbi mënyrën se si është llogaritur vlera e ofertuar nga ana e tyre, pasi në rast të kundërt, do të procedohet me s’kualifikimin e ofertave të tyre.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin e mësipërm pasi oferta e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të jetë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të janë origjinalë ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar shërbimit që kërcohët të kryhet, atij të mbikqyrjes së punimeve, në zbatim të nenit 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “*Për Prokurimin publik¹*”, dhe nenit 15 pika 3 gërmë “c”, e nenit 41 pika 1 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), ligjit **Nr.8402, datë 10.09.1998** “*Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 610, datë 22.09.2022** “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*”, dhe Udhëzimi **Nr.2, datë 13.05.2005** “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, njësia e prokurimit kreuz hartimin dhe miratimin e specifikimeve teknike/ termave të refencës për shërbimin e secilit lot objekt prokurimi, si më poshtë:

Afat i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë, i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërcohët nga investitori.

Vlera e investimit është:

- Objekti i investimit: “**Rikonstruksion i rrjetit te linjes se furnizimit te ujesjellesit nga Impianti i Bovilles - Depo Maloku, Bashkia Kamez**”, me fond limit në vlerën: **63,014,765.5 (Gjashtëdhjetë e tre milion e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë pesë) pa TVSH.**

1. Objktivi kryesor i Mbikqyrësit

1.1 Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarevajtjen e gjithe procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

2. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyrësit

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Kontraktor dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislacionit në fuqi.
- Të njihet në detaj me projekt - zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve.
- Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.

- Në bazë të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyrësi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plotë në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyrës mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.

2.2 Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.

2.3 Mbikqyrësi vë në dijeni Autoritetin Kontraktor për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh Sipërmarrësi (*Zbatuesi i Punimeve*) në përputhje me konratën e zbatimit të punimeve, kur kjo është e lejuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit objekt investimi.

2.4 Mbikqyrësi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridikcionin e të cilët ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin/ rehabilitimin e objektit, në përputhje me legjisacionin në fuqi (*neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998, i ndryshuar*).

3 Detyrat e mbikqyrësit

3.1 Mbikqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe gati për të filluar punimet.
- Të njihet me hollësi me konratën e zbatimit të punimeve dhe të gjithë akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:
 - *Emërtimi i objektit:*
 - *Data e marrjes së lejes së ndërtimit:*
 - *Investitori:*
 - *Projektuesi:*
 - *Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik:*
 - *Mbikqyrësi:*
 - *Afati i ndërtimit të objektit:*
 - *Vlera e objektit:*

3.2 Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenerëve, etj.
- Mbës verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku të përfshihen:
 - Stafi i sipërmarrësit

- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit
- Pikit e marrjes së lëndëve të para
- Zonat e ngritjes së kantjerit
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e Sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit.
- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe t'i propozojë Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë (fotografimin ose regjistrim e tij) dhe të mbajë proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarësit.
- Në çdo fund dite pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmosë atë.
- Të kontrollojë librezën e masave, e cila vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt.
- Gjatë zbatimit të projektit, i jep udhezime me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme dhe Sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit, ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me udhëzimet dhe urdhërat e marra.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një relacion të plotë teknik, shoqëruar me skicat përkatëse ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt, gjatë zbatimit të punimeve, do të bëhet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
- Në çdo fund muaji, Mbikqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor raport mënyrë së përmirësojshmërinë e punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tabllo e qartë e progresit të punimeve dhe të pagesave të kryera, realizimi i punimeve në vlerë dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
- Korrespondencia ndërmjet palëve bëhet gjithnjë në mënyrë zyrtare, me shkrim.

3.3 Raporti Mujor do të përbajë lëndën e mëposhtme:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
 - *Të përgjithshme*
 - *Qëllimi i punimeve*
 - *Mbikqyrja e punimeve ndërtimore*
- Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi
 - *Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve*
 - *Stafi aktual*

- *Kohëqëndrimi në objekt për secilin pjesëtar të stafit mbikqyrës*
- Raportimi
- Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes
- Përshkrimi i Projektit
 - *Karakteristikat teknike dhe të dhëna për objektin specifik*
- Organizimi i Sipërmarrësit
 - *Sipërmarrësi*
 - *Stafi prezent*
 - *Mjete dhe makineri*
 - *Kohëqëndrimi në objekt*
- Progresi Mujor
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)
- Fotografi të proceseve të punimeve të kryera
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm
- Grafiku i ecurisë së punimeve
 - *Të aprovuara*
 - *Të kryera*
- Volumet Progresive të Punimeve Mujore
 - *Punimet e Aprovuara*
 - *Certifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike*
 - *Libreza e Masave*
 - *Punimet e Kryera por të pa aprovuara*
 - *Situacionet mujore*
 - *Matjet topografike*
- Korrespondenca
 - *Proces-Verbale*
 - *Urdhëra, Udhëzime, Njoftime*
 - *Ndryshime në Projekt - Preventiv nëse ka (të aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)*
- Moti (kalendarik)
- Problemet që kanë dalë
 - *Teknike*
 - *Sociale*
- Konkluzione

4. Përgjegjësítë e Mbikqyrësit

4.1 Në fillim të punimeve Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vendimin e sheshit të ndërtimit dhe lejen origjinale zhvillimore (nëse ka).
- Projekt - zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikit teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
- Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.

- Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin me korrektësi të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë Mbikqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korrespondencën me Autoritetin Kontraktor, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të këruara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrëthanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.
- Në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të Mbikqyrësit, për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon Mbikqyrësi, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces-verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

5. Të drejtat e Mbikqyrësit

5.1 Mbikqyrësi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të Drejtuesit të Kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rendë.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, etj, nqs këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezulloje punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të kërkojë çertifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale.
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurta dhe cilësore.
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme nqs ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga Mbikqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave, se bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangjet e palejuara referuar standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
- Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
- Kur Mbikqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë Mbikqyrësit, shpenzimet janë në

ngarkim të Sipërmarrësit. Në rast të kundërt, Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

- Mbikqyrësi i punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast, me miratimin e Autoritetit Kontraktor për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast, sipas fajit, Mbikqyrësi së bashku me Autoritetit Kontraktor dhe Sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Kontraktor për gjendjen e tij. Në rast se Autoriteti Kontraktor ka vërejtje e njofton Sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Për çdo ndryshim të mundshëm në objekt, Mbikqyrësi i punimeve vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

5.2 Në përfundim të punimeve Mbikqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proçes-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej Kontraktorit dokumentacionin përkatës.
- Sipas legjislacionit në fuqi dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

5.3 Ky dokumentacion duhet të përbajë:

- *Proçes-verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit*
- *Proçes-verbalin për fillimin e punimeve*
- *Kontratën e Sipërmarrjes*
- *Kontratën e Mbikqyrjes*
- *Projekt organizimin e punimeve*
- *Projektin teknik të zbatimit*
- *Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme*
- *Preventivin fitues*
- *Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve, negocimin e tyre)*
- *Grafikun e punimeve*
- *Specifikimet teknike*
- *Azhornimin para fillimit të punimeve dhe piketimi*
- *Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik për punime të paparashikuara*
- *Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme*
- *Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyrësi të shoqëruar me fotografi*
- *Ditarin e objekteve ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga Mbikëqyrësi*

- *Librezën e masave*
- *Shkresën e Mbikqyrësit për investorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës*
- *Proçes-verbalin e përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi]*
- *Preventivin e fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi*
- *Situacionin e fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi*
- *Certifikatat e cilësisë së materialeve*
- *Miratimin e materialeve të përdorura nga Mbikqyrësi*
- *Situacionet pjesore dhe situacioni përfundimtar*
- *Regjistrin e kontabilitetit*
- *Deklaratën teknike të Sipërmarrësit të firmosur nga Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik*
- *Njoftimin e sipërmarrësit për përfundimin e punimeve*
- *Proçes-verbalin e përfundimit të punimeve të firmosur nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi, së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar*
- *Relacionin përfundimtar të Mbikqyrësit*

5.4 I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e Mbikqyrësit. Ky dokumentacion përgatitet e dorëzohet në 3 (*tre*) kopje.

5.5 Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë grupit të kolaudimit duhet të jenë origjinale.

5.6 Mbikqyrësi i punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos. Pas përfundimit të kolaudimit, Mbikqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur Sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar Autoritetit Kontraktor.

6 Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes

6.1 Shërbimi i mbikqyrjes zgjat për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve dhe periudhës së garancisë së punimeve.

6.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike

- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të urdhërojë Mbikqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi.
-
- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
 - **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njësisë së Prokurimit.**
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të proçedurës së prokurimit do të jetë **data 24.06.2024, ora 12.00, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al**.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT